



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 14 dhjetor 2020
Nr. ref.:RK 1662/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

rastin nr. KIo8/20

Parashtrues

Naser Husaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Rev.nr. 465/2019, të 11 dhjetorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Naser Husaj nga Komuna e Pejës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev.nr.465/2019] të 11 dhjetorit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr.2740/13] e 30 tetorit 2015 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C.nr.21/10] e 19 qershorit 2013 të Gjykatës Themelore në Pejë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

5. Më 13 janar 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 17 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci.
7. Më 24 janar 2020, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 5 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi në Gjykatë dokumentet shtesë si në vijim (i) Aktgjykimin [C.nr.21/10] e 19 qershorit 2013 të Gjykatës Themelore; (ii) Kontratën për shitblerje të paluajtshmërisë të 6 shtatorit 2008 të lidhur ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe personit R.J.; (iii) deklaratën e 15 marsit 2013 nga personi H.N. përkitazi me Kontratën e shitblerjes të lidhur ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe personit R.J.; (iv) deklaratën e 18 marsit 2013 nga personat U.H., dhe A.H., përkitazi me Kontratën e shitblerjes të lidhur ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe personit R.J.; (v) listën e trashëgimtarëve të trashëgimlënësit R.J. të 24 nëntorit 2008 të përpiluar në Beograd; dhe (vi) kopjen e letërnjoftimit të personit M.J.

9. Më 25 nëntor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës paraqitet para Gjykatës për herën e tretë. Herën e parë, parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev.nr.335/2015] të 14 dhjetorit 2015 të Gjykatës Supreme. Kjo kërkesë ishte regjistruar me nr. KI22/16. Në këtë rast, Gjykata kishte konstatuar shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, duke e shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin e kontestuar dhe duke e kthyer çështjen në rishqyrtim në Gjykatën Supreme. Rasti i tanishëm ndërlidhet me kontestimin e Aktgjykimit të nxjerrë nga Gjykata Supreme si pasojë e Aktgjykimit KI22/16.
11. Ndërsa, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës gjithashtu kishte kontestuar Aktgjykimin [Rev. nr. 170/2017] e 23 gushtit 2017 të Gjykatës Supreme, në një rast tjetër e që nuk ndërlidhet me rrethanat faktike dhe juridike të rastit konkret, dhe në të cilin, Gjykata përmes Aktgjykimit në rastin nr. KI128/17 të 28 gushtit 2019 (në tekstin e mëtejme: rasti i Gjykatës KI128/17), kishte shpallur Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme në përputhshmëri me Kushtetutën. Në vijim, Gjykata do përmbledh faktet e rastit konkret, duke përfshirë ato të rastit të Gjykatës KI22/16, për aq sa janë relevante për rrethanat e rastit të tanishëm.
12. Më 20 janar 2010, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore kundër të paditurës M.J. me pretendimin se nga bashkëshorti i saj, përkatësisht S.J., dhe i cili tashmë kishte vdekur, kishte blerë ngastrat kadastrale nr. 217, 220, 221, 224/1, 225, 227/1, 230/1, 230/2, 240/1, 241, 242/3, 245/1, dhe 245/3 në sipërfaqe të përgjithshme prej 5.40,91 ha, për çmimin e kontraktuar në shumë prej 30.000 euro (në tekstin e mëtejme: ngastrat kontestuese). Parashtruesi i kërkesës i kishte propozuar Gjykatës Themelore që përmes Aktgjykimit të vërtetohet se i njëjti është pronar i ngastrave kontestuese.
13. Më 29 maj 2013, parashtruesi i kërkesës kishte precizuar kërkesëpadinë, duke theksuar gjithashtu se (i) ai kishte paguar çmimin e kontraktuar prej 20.000 euro, duke e përmbushur kështu pjesën më të madhe të detyrimit kontraktual, ndërsa shumën e mbetur prej 10.000 euro, nuk ka mundur ta paguaj për shkak të mosbashkëpunimit të të paditurës M.J., dhe se për pasojë, bazuar në dispozitat e neneve 54 (Forma e kontraktuar), 56 (Kushti i plotësisë së dokumentit), 58 (Kur kontrata e përmbushur të cilës i mungon forma me shkrim është e vlefshme), 67 (Kthimi dhe llogaritja e kaparit) dhe 68 (Mos përmbushja e kontratës) të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejme: LMD), gëzon të drejtën e përmbushjes së kontratës ose kompensim të dëmit përkatës; (ii) ngastrat kontestuese ishin blerë në vitin 2000, fillimisht nga i biri i tij, përkatësisht U.H., ndërsa më vonë me riformulimin e Kontratës, cilësinë e blerësit e ka pasur parashtruesi i kërkesës; dhe (iii) duke marrë parasysh që ai është mbajtës i ligjshëm i paluajtshmërisë për më shumë se trembëdhjetë (13) vjet, kërkesëpadia e tij duhet të aprovohet si e bazuar.

14. Më 19 qershor 2013, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.21/10] vendosi që të refuzohet e pabazuar padia e parashtruesi i kërkesës. Përmes këtij Aktgjykimi, Gjykata Themelore, ndër të tjera, kishte theksuar si në vijim: (i) nuk qëndron pretendimi i parashtruesit të kërkesës se paluajtshmërinë e kontestuar e kishte blerë i biri i tij në vitin 2000, sepse Kontratat e datës 20 mars 2006 dhe 6 shtator 2008, vërtetojnë të kundërtën; (ii) shkresat e lëndës vërtetojnë se parashtruesi i kërkesës në mes viteve 2006 e 2007, i kishte paguar shumat në vlerë prej 8,800 euro në llogari të S.J.-së, dhe i cili ishte i biri i pronarit të paluajtshmërisë, përkatësisht R.J.; (iii) deklaratat e dëshmitarëve U.H., A.H. dhe H.N. nuk u pranuan si të besueshme, sepse *“të njëjtit nuk u deklaruan se kanë qenë prezent as kur është lidhur kontrata e shitblerjes dhe as kur është dorëzuar çmimi kushtues”*; (iv) pretendimi i parashtruesit të kërkesës që e ka fituar të drejtën e pronësisë edhe me mbajtje është i pabazuar sepse i njëjti nuk ka përmbushur në tërësi detyrimin që rrjedhë nga Kontrata, duke e paguar vetëm çmimin prej 8,800 euro, dhe për më tepër, që afati i parashkrimit është ndërprerë përmes paraqitjes së padisë më 20 janar 2010, dhe rrjedhimisht nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 28 [pa titull] të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore të 30 janarit 1980 (në tekstin e mëtejme: LTHMPJ); (v) pretendimi i parashtruesit të kërkesës se kontrata e shitblerjes nuk i nënshtrohet asnjë forme është i pasaktë, ngase bazuar në paragrafin 1 të nenit 67 (Mosformaliteti i kontratës) të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të 30 marsit 1978 (në tekstin e mëtejme: LMD i vjetër), *“kontrata për shitblerjen është rreptësisht formale dhe nga forma e saj varet vlefshmëria punës juridike”*; dhe se, (vi) në rastin konkret, përkitazi me shumën e paguar prej 8,800 euro, përkatësisht kompensimin e dëmit apo pasurimin e pabazë, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë padi kundër trashëgimtarëve të të ndjerit.
15. Më 27 korrik 2013, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Aktgjykimi i atakuar të anulohet dhe çështja e tij të kthehet në rivendosje. Parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimeve dhe të cilat i kishte paraqitur edhe para Gjykatës Themelore, mes tjerash, kishte theksuar se (i) nga koha kur janë blerë ngastrat e kontestuar deri kur parashtruesi i kërkesës ka paraqitur padinë për vërtetim të pronësisë, kanë kaluar dhjetë (10) vjet, sepse e paditura M.J., nuk kishte arritur që të bartë trashëgiminë e R.J.-së tek të gjithë trashëgimtarët e tij, dhe se rrjedhimisht konstatimi i Gjykatës Themelore se parashtruesi i kërkesës nuk e kishte fituar pronësinë *“me mbajtje, si posedues me mirëbesim”*, ishte i pasaktë; (ii) qëndrimi i Gjykatës Themelore se me rastin e vdekjes së autorizimdhënësit R.J., S.J.-së i kanë pushuar të gjitha të drejtat dhe autorizimet që dalin nga prokura është gjithashtu i pasaktë dhe *“joprofesional”*, sepse trashëgimtari është i autorizuar që ta vazhdojë procedurën dhe se vdekja e autorizimdhënësit nuk ndikon në Kontratën e shitblerjes; (iii) e bija e R.J.-së, përkatësisht D.J. ka falsifikuar Kontratën mbi mbajtjen e përrjetshme së bashku me M.G.-në; dhe se, (iv) Gjykata Themelore *“qëllimisht ka kryer shkelje duke thënë se deklaratat e dëshmitarëve R.M., F.M. dhe S.N. nuk janë relevante, gjoja se ata nuk kanë qenë prezent kur është lidhur kontrata e shitblerjes”*.

16. Më 26 nëntor 2014, bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Shtetit kundër gjyqtarit Q.A. për shkak të veprës penale të përcaktuar përmes nenit 422 (Keqpërdorimi i pozitës apo detyrës zyrtare) të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK).
17. Më 30 tetor 2015, Gjykata e Apelit, në kolegjin e së cilës merrte pjesë edhe gjyqtari Q.A., përmes Aktgjykimit [AC. nr. 2740/2013] refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [C.nr.21/10] e 19 qershorit 2013 të Gjykatës Themelore.
18. Më 20 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, kishte pretenduar se (i) gjyqtari Q.A. nuk është dashur të jetë pjesë e kolegjit të Gjykatës së Apelit sepse kundër të njëjtit, më 26 nëntor 2014, kishte paraqitur kallëzim penal për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo detyrës zyrtare; dhe (ii) gjyqtari Q.A. së bashku me gjyqtarin H.SH., të dy anëtarë të kolegjit, *“janë marrë me lëndën e parashtruesit të kërkesës për qëllime të hakmarrjes dhe revanshit”*. Përkitazi me themelësinë e padisë së tij, parashtruesi i kërkesës, kryesisht kishte përsëritur pretendimet e paraqitura edhe para gjykatave më të ulëta.
19. Më 14 dhjetor 2015, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 335/2015] refuzoi të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit të paraqitur kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme, në refuzimin e revizionit, nuk kishte trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me pjesëmarrjen e gjyqtarit Q.A. në kolegjin e Gjykatës së Apelit, kundër të cilit, parashtruesi i kërkesës në vitin 2014 kishte paraqitur kallëzimin penal.
20. Më 1 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë në Gjykatë duke kontestuar Aktgjykimin [Rev.nr.335/2015] e 14 dhjetorit 2015 të Gjykatës Supreme. Kërkesa ishte regjistruar me numër KI22/16. Parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje e nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me mungesën e arsytimit rreth anshmërisë së Gjykatës së Apelit, për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarit Q.A. në kolegjin përkatës.
21. Më 9 qershor 2017, përmes Aktgjykimit në rastin nr. KI22/16, Gjykata kishte shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin [Rev.nr.335/2015] e 14 dhjetorit 2015 të Gjykatës Supreme, duke e kthyer çështjen në rishqyrtim tek kjo e fundit. Përmes Aktgjykimit KI22/16, Gjykata kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së vendimit të arsytuar gjyqësor, specifikisht sepse Gjykata Supreme nuk kishte trajtuar dhe as arsytuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pjesëmarrjen e gjyqtarit Q.A. në vendimmarrjen në Gjykatën e Apelit.
22. Më 11 dhjetor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.465/2019] e refuzoi të pathemeltë revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit [Ac.nr.2740/2013] të 30 tetorit 2015 të Gjykatës së Apelit. Përmes këtij Aktgjykimi, Gjykata Supreme kishte shqyrtuar dy çështje qendrore: (i) ndikimin e pjesëmarrjes së gjyqtarit Q.A. në kolegjin e Gjykatës së Apelit në

nxjerrjen e Aktgjykimit [AC.nr.2740/2013] e 30 tetorit 2015; dhe (ii) pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me vërtetimin e pronësisë së tij në ngastrat kontestuese të ngritura përmes kërkesës për revizion të datës 20 nëntor 2015.

23. Përkitazi me pjesëmarrjen në procesin gjyqësor të gjyqtarit Q.A. në kolegjin përkatës së Gjykatës së Apelit, për mungesën e arsytimit rreth të cilës çështje, Gjykata Kushtetuese e kishte shpallur Aktgjykimin e parë të Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.335/2015] e 14 dhjetorit 2015, si të pavlefshëm dhe e kishte kthyer çështjen në rishqyrtim, përmes Aktgjykimit të dytë, përkatësisht Aktgjykimit [Rev.nr.465/2019] të 11 dhjetorit 2019, Gjykata Supreme, kishte arsyetuar, ndër të tjera, si në vijim: (i) Kolegji i Gjykatës së Apelit ishte i përbërë nga tre gjyqtarë, secili prej tyre i pavarur, dy prej të cilëve paraqesin një shumicë legjitime të gjyqtarëve, të mjaftueshëm për të marrë vendim të drejtë sipas ankesës së paditësit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës; (ii) nuk është i argumentuar pretendimi i parashtruesit të kërkesës se gjyqtari Q.A. *“është dashur të lirohet nga pjesëmarrja në këtë kolegji, dhe se i njëjti ka ndikuar në të dy kolegjet e tij në kolegji që padrejtësisht parashtruesit të kërkesës t’i refuzohet ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë”*; (iii) fakti se parashtruesi i revizionit, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, kishte paraqitur kallëzim penal kundër gjyqtarit Q.A. *“i pambështetur në rrethana dhe argumente tjera”*, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar se gjyqtari Q.A. ka qenë i anshëm në kuptimin e testit subjektiv dhe se kolegji i Gjykatës së Apelit që ka nxjerrë Aktgjykimin e kontestuar, të ketë qenë i anshëm në kuptimin e testit objektiv të paanshmërisë; dhe (iv) dyshimet e parashtruesit të kërkesës për pjesëmarrjen e gjyqtarit Q.A. në kolegjin përkatës të Gjykatës së Apelit, nuk janë objektivisht të justifikueshme bazuar në parimet dhe kriteret e përcaktuara nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar [Rev.nr.465/2019] të 11 dhjetorit 2019 të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
25. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se (i) Aktgjykimi i kontestuar [Rev.nr.465/2019] i 11 dhjetorit 2019 i Gjykatës Supreme, nuk ka *“vepruar sipas aktgjykimit KI22/16 të Gjykatës Kushtetuese, duke mos marrë parasysh rekomandimet e atij aktgjykimi”*; dhe (ii) *“kur shpallet i pavlefshëm Aktgjykimi i Gjykatës Supreme sipas revizionit shpallen të pavlefshme të gjitha aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore dhe lënda kthehet në rigjykim në shkallë të parë”*.
26. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se Gjykata Supreme *“ka kryer shkelje të shumta procedurale dhe profesionale”*. Në këtë kontekst, ai iu referohet dëshmive siç janë (i) Kontrata e shitblerjes së ngastrave kontestuese e lidhur ndërmjet tij dhe S.J.-së, përkatësisht të birit të pronarit të ngastrave

kontestuese, R.J., dëshmi kjo e cila, sipas parashtruesit të kërkesës, vërteton “se janë paguar 20.000 euro, pra më tepër se gjysma dhe konsiderohet se pagesa është kryer”; (ii) deklaratat e U.H.-së, A.H.-së dhe H.N.-së të 15 dhe 18 marsit 2013, të cilët deklarojnë se S.J. “i ka pranuar 20.000 euro, me ç’rast kishte mbetur të paguhet pjesa tjetër e shumës për paluajtshmërinë e kontestuar, pasi që SJ ta sjellë dokumentacionin origjinal dhe prona të përkthehet”; (iii) shkresa e M.J.-së, përkatësisht bashkëshortes së S.J.-së të 24 nëntorit 2008, “ku thuhet se të gjithë fëmijët e RJ kanë qenë trashëgimtar”; dhe (iv) faktin se D.J., përkatësisht e bija e R.J.-së, kishte “falsifikuar dokumentacion e mbajtjes së përjetshme të babait të saj RJ”. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se gjyqtari i Gjykatës Themelore, përkatësisht A.B., i cili ka marrë pjesë në nxjerrjen e Aktgjykimit [C.nr.21/10] të 19 qershorit 2013 në Gjykatën Themelore, “ka ndikuar në vendimmarrjen e aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme” për shkak se parashtruesi i kërkesës “ka paraqitë padi për kompensim dëmi kundër tij”.

27. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) kërkesa e tij të shpallet e pranueshme; dhe (ii) të shpallen të pavlefshëm Aktgjykimet: [Rev. nr.465/19] i 11 dhjetorit 2019 i Gjykatës Supreme, [Ac.nr.2740/2013] i 30 tetorit 2015 i Gjykatës së Apelit dhe [C.nr.21/10] i 19 qershorit 2013 i Gjykatës Themelore.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2.Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 46

[Mbrojtja e Pronës]

1.E drejta e pronës është e garantuar.

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
[...]

Protokolli nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 1 (Mbrojtja e pronës)

1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.
[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”
30. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve, 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

31. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.465/2019] e 11 dhjetorit 2019 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
32. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:
- “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*
33. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

34. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*. (Shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *“qartazi të pabazuar”*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *“qartazi të pabazuara”*, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 31 gushtit 2019; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284).
35. Në këtë kontekst, dhe në vijim, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në rrethanat e këtij rasti, vlerësimit nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
36. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, kontesti gjyqësor ndërlidhet me një Kontratë të vitit 2006 në vlerë prej 30,000 eurosh mes të parashtruesit të kërkesës dhe S.J.-së, i biri i trashëgimlënësit R.J., lidhur me ngastrat kontestuese. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ka përmbushur pjesën më të madhe të Kontratës sepse ka paguar 20,000 euro nga kjo shumë, për më tepër që, gjithashtu pretendon se ka fituar të drejtën e kësaj pronësie si mbajtës në mirëbesim me kalimin e kohës së nevojshme bazuar në dispozitat e LTHMPJ-së. Megjithatë, pretendimet e parashtruesit të kërkesës, janë refuzuar nga gjykatat e rregullta. Ndër të tjera, të njëjtat kanë konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk është pronar i ngastrave kontestuese sepse i njëjti ka paguar vetëm vlerën prej 8,800 euro, duke e udhëzuar parashtruesin e kërkesës në kontest civil përkitazi me kompensimin e dëmit përkatës lidhur me shumën e paguar. Në ndërkohë, dhe përderisa ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte në pritje para Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte bërë kallëzim penal kundër njërit prej gjyqtarëve pjesëmarrës në kolegjin e Gjykatës së Apelit. Duke marrë parasysh që kjo e fundit kishte refuzuar pretendimet e tij si të pabazuara dhe kishte konfirmuar konstatimet e Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës, përmes revizionit në Gjykatën Supreme, kishte kontestuar pjesëmarrjen e gjyqtarit Q.A., në kolegjin përkatës të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Rev.nr.335/2015] të 14 dhjetorit 2015, kishte shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës të ngritura përmes revizionit duke i refuzuar të njëjtat, por nuk kishte trajtuar pretendimet që ndërlidheshin me paanshmërinë e Gjykatës së Apelit për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarit Q.A. në kolegjin përkatës. Për pasojë, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës, duke pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të

KEDNJ-së, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor përkitazi me anshmërinë e Gjykatës së Apelit, si rezultat i pjesëmarrjes së gjyqtarit Q.A. në kolegjin përkatës. Gjykata përmes Aktgjykimit KI22/16, e kishte shpallur Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Supreme në kundërshtim me nenet 31 të Kushtetutës dhe 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, vetëm dhe specifikisht, lidhur me pretendimin për anshmërinë e Gjykatës së Apelit, përkatësisht pjesëmarrjen e gjyqtarit Q.A. në kolegjin përkatës, dhe e kishte kthyer rastin në Gjykatën Supreme.

37. Në rishqyrtim Gjykata Supreme, kishte nxjerrë Aktgjykimin [Rev.nr.465/2019] e 11 dhjetorit 2019, sërish duke i refuzuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pronësinë e ngastrave kontestuese, por gjithashtu duke i trajtuar pretendimet specifike që ndërlidhen me pjesëmarrjen e gjyqtarit Q.A. në vendimmarrjen në Gjykatë të Apelit. Parashtruesi i kërkesës sërish e konteston këtë Aktgjykim para Gjykatës, duke pretenduar, ndër të tjera, se Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 46 të Kushtetutës. Përkitazi me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar (i) sërish nuk është i arsyetuar dhe rrjedhimisht nuk është zbatuar Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI22/16; dhe (ii) nuk është i drejtë sepse nuk janë marrë parasysh dëshmitë e tij, duke ngritur në esencë pretendime që ndërlidhen me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe zbatimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta.

38. Gjykata në vijim do t'i trajtoj pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke filluar me ato që ndërlidhen me (i) zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI22/16 dhe mungesën e arsytimit të Aktgjykimit të kontestuar, për të vazhduar me tej me (ii) pretendimet që ndërlidhen me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe zbatimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta dhe shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës.

(i) *Sa i përket pretendimeve që ndërlidhen me moszbatimin e Aktgjykimin të Gjykatës në rastin KI22/16 dhe mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor*

39. Gjykata thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rosisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues "IKK Classic", Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, *Muharrem Blaku dhe të*

tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; dhe KI24/17, me parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 17 majit 2019.

40. Në parim, praktika gjyqësore e GJENDJ-së dhe ajo e Gjykatës theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet “*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ato bazuan vendimin e tyre*”. Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm.
41. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që Aktgjykimi i parë i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [Rev.nr.335/2015] i 14 dhjetorit 2015 dhe i cili ishte shpallur i pavlefshëm nga Gjykata përmes rastit KI22/16, nuk kishte përmbajtur asnjë arsyetim përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me anshmërinë e kolegjit të Gjykatës së Apelit për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarit Q.A. në vendimmarrjen e saj dhe kundër të cilit, parashtruesi i kërkesës në vitin 2014, kishte paraqitur kallëzim penal.
42. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur, Gjykata, ndër të tjera, (i) kishte cilësuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me anshmërinë e kolegjit të Gjykatës së Apelit si pretendim të natyrës thelbësore dhe për pasojë kishte konstatuar se (ii) mos adresimi i këtij pretendimi nga ana e Gjykatës Supreme është në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor. (Shih, rastin e Gjykatës KI22/16, paragrafët 39 deri 51). Siç është sqaruar më lart, Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI22/16, kishte kthyer çështjen e parashtruesit të kërkesës në rishqyrtim në Gjykatën Supreme vetëm dhe specifikisht përkitazi me mos arsyetimin e pretendimeve që ndërlidhen me pjesëmarrjen e gjyqtarit Q.A. në kolegjin e Gjykatës së Apelit, përkatësisht pretendimeve për anshmërinë e kësaj të fundit.
43. Aktgjykimi i dytë i Gjykatës Supreme, i nxjerrë si rezultat i Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI22/16, në adresimin e vërejtjeve të Gjykatës, kishte dhënë arsyetimin e mëposhtëm:

“Pretendimet e lartpërmendura të revizionit të paditësit, Gjykata Supreme e Kosovës i refuzoi të pabazuara ngase në parim edhe nëse mund të ketë konflikt potencial të interesit me një nga gjyqtarët, Kolegji i Apelit është i përbërë nga tre gjyqtarë, secili prej tyre i pavarur, dy prej të cilëve paraqesin një shumicë legjitime të gjyqtarëve, për të marrë vendimin sipas ankesës së paditësit. Për më tepër, nuk është argumentuar pretendimi i paditësit se gjyqtari për të cilin paraqitësi i revizionit pretendon se ka qenë dashtë të lirohet nga pjesëmarrja në këtë kolegji, dhe se i njëjti ka ndikuar në të dy kolegjet e tij në kolegji që padrejtësisht paditësit t’i refuzohet ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Fakti se parashtruesi i revizionit kishte paraqitur kallëzim penal kundër anëtarit të kolegjit të Gjykatës së Apelit Qerim Ademaj, i pa mbështetur në rrethana dhe argumente tjera, nuk është i mjaftueshëm për të determinuar se gjyqtari Qerim Ademaj ka

qenë i anshëm në kuptimin e testit subjektiv të paanshmërisë së gjykatës dhe se kolegji i Gjykatës së Apelit ka nxjerrë aktgjykimin e goditur me revizion, të ketë qenë i anshëm në kuptimin e testit objektiv të paanshmërisë së gjykatës. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstaton se dyshimet për njëanshmërinë e Gjykatës së Apelit, në rrethant e rastit konkret, nuk janë objektivisht të justifikueshme. Edhe pse në përbërje të kolegjit të Gjykatës së Apelit i cili nxori aktgjykimin e kundërshtuar me revizion, ishte një gjyqtar kundër të cilit parashtruesi i revizionit nuk e përmbys prezumimin e paanësisë së gjyqtarit përkatës, dhe për më tepër, përkundër faktit që pjesëmarrja e gjyqtarit përkatës në kolegjin e Gjykatës së Apelit mund të ketë ngritur dyshime legjitime për paanësinë e gjykatës nga ana e parashtruesit të revizionit, në vlerësimin e gjykatës, vlerësim ky i bazuar në parimet dhe kriteret e përcaktuara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, këto dyshime, në rrethanat e rastit konkret, nuk janë objektivisht të justifikueshme. Ngjashëm, ka vendosur edhe Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin e saj Agj,nr.1414/2019 datë 26 gusht 2019, në rastin KI128/17 sipas kërkesës së po të njëjtës palë Naser Husaj, me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 170/2017 datë 23 gusht 2017.”

44. Në kontekst të arsyetimit të mësipërm të Gjykatës Supreme, Gjykata vëren se Aktgjykimi i kontestuar (i) aplikon testin subjektiv dhe objektiv lidhur me paanshmërinë e një gjykate; (ii) adreson pjesëmarrjen e gjyqtarit Q.A. në kolegjin e Gjykatës së Apelit dhe thekson se fakti që kundër tij parashtruesi i kërkesës ka ngritur kallëzimin penal, e që për më tepër, ndërlidhet me vendimmarrjen e tij gjyqësore, “i pambështetur në argumente tjera” nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar se gjyqtari përkatës ka qenë i anshëm; dhe (iii) thekson se në rrethanat e rastit, në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dyshimet legjitime që mund të jenë ngritur si pasojë e pjesëmarrjes së gjyqtarit Q.A. në kolegjin e Gjykatës së Apelit, nuk janë objektivisht të justifikueshme.
45. Gjykata gjithashtu thekson se në arsyetimin e këtij pretendimi të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme, ishte referuar edhe në konstatimet e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI128/17. Ky i fundit, ishte nxjerrë përkitazi me një procedurë tjetër gjyqësore në të cilin i njëjti parashtrues i kërkesës është palë dhe që nuk ndërlidhet me rrethanat faktike të rastit konkret. Megjithatë, është relevante të theksohet që Aktgjykimi KI128/17 kishte shtjelluar (i) parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së lidhur me kriteret për vlerësimin e paanësisë së një gjykate; (ii) konceptin e paanësisë subjektive dhe objektive të gjykatës; dhe (iii) praktikën e GJEDNJ-së në aspekt të vlerësimit të paanshmërisë së gjykatës, përkatësisht konceptin e “*dyshimeve legjitime*” dhe faktit që të njëjtat duhet të jenë “*objektivisht të justifikueshme*” në mënyrë që të konstatohet paanësia e një gjykate. (Shih, gjithashtu rastet e Gjykatës KI24/17 parashtrues, *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 17 majit 2019, cituar më lart, paragrafët 54-74 dhe KI187/19 e KI11/19 parashtrues, *Muhamet Idrizi*, Aktgjykim i 29 korrikut 2019, paragrafët 58, 59, 70 dhe 81). Këto parime ishin përfshirë dhe aplikuar përmes arsyetimit të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.
46. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se arsyetimi i Gjykatës Supreme në Aktgjykimin e kontestuar [Rev.nr.465/2019] të 11 dhjetorit 2019 është (i) në

përputhje me kërkesat dhe konstatimet e Gjykatës në rastin KI22/16, dhe rrjedhimisht ka zbatuar drejtë këtë Aktgjykim; dhe (ii) në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së përkitazi me vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me paanësinë e një gjykate, siç është shtjelluar ndër të tjera, në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI128/17.

47. Për pasojë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse Aktgjykimi i kontestuar nuk është i arsyetuar dhe për pasojë nuk është zbatuar Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI22/16, reflektojnë *“mungesë të dukshme ose të qartë të shkeljes”*, dhe si të tilla, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

48. Më tej, Gjykata do shqyrtojë pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e (i) nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; dhe (ii) nenit 46 të Kushtetutës.

(ii) *Sa i përket pretendimeve të tjera për shkelje të nenit 31 dhe 46 të Kushtetutës*

49. Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve të tjera të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar, *“ka kryer shkelje të shumta procedurale dhe profesionale”*. Në mbështetje të këtij pretendimi, siç është sqaruar më lart, parashtruesi i kërkesës, vë theks, ndër të tjera, në (i) Kontratën e shitblerjes, e mbi bazën e të cilës ai pretendon se ka *“paguar 20.000 euro, pra më tepër se gjysma dhe konsiderohet se pagesa është kryer”*, konstatim ky të cilin e kanë refuzuar të gjitha gjykatat e rregullta; (ii) deklaratat e U.H.-së, A.H.-së dhe H.N.-së, dëshmi të cilat i kanë dëgjuar gjykatat e rregullta, por nuk kanë rezultuar në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike sipas tyre; dhe (iii) *“falsifikimin e dokumentacionit të mbajtjes së përjetshme të babait të saj RJ”*, nga personi D.J., e të cilat i kanë shqyrtuar dhe hedhur poshtë si të pabazuara gjykatat e rregullta.

50. Në këtë aspekt, Gjykata duhet të ritheksojë se parashtruesi i kërkesës, para saj, në esencë, ngre pretendime që ndërlidhen me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe zbatimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, pretendime këto të cilat, Gjykata, bazuar në praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, i konsideron si *“pretendime të shkallës së katërt”*.

51. Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, sqarimin në Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2. “Shkalla e katërt”, paragrafët 262 dhe 263), parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të *“kushtetutshmërisë”* dhe *“ligjshmërisë”* dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit

dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60; dhe KI179/18, parashtruese *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 24 qershorit 2020, paragrafi 68).

52. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe ajo se nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI49/19, cituar më lart, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 61; dhe KI179/18, Aktvendim për papranueshmëri, cituar më lart, paragrafi 69).
53. Në këtë drejtim, dhe në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, Gjykata nuk mund, si rregull i përgjithshëm, të vë në dyshim gjetjet dhe konkluzionet e gjykatave të rregullta që kanë të bëjnë me: (i) vërtetimin e fakteve të rastit; (ii) interpretimin dhe zbatimin e ligjit; (iii) pranueshmërinë dhe vlerësimin e provave në gjykim; (iv) drejtësinë substanciale të rezultatit të një kontesti civil; apo edhe (v) fajin ose pafajësinë e të akuzuarit në procedurën penale. (Shih, gjithashtu, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2."Shkalla e katërt", paragrafi 264).
54. Gjykata gjithashtu thekson faktin se në vlerësimin e pretendimeve "*të shkallës së katërt*" e që ndërlidhen me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ajo gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se "*drejtësia*" e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është një drejtësi "*substanciale*", por drejtësi "*procedurale*". Në aspektin praktik, ky koncept, në parim, nënkupton (i) mundësinë e procedurave kontradiktore; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të këtyre procedurave, të sjellin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat në mënyrë të duhur; dhe se, për pasojë, procedura, marrë si tërësi, do të rezultonte si e drejtë. (Shih, gjithashtu, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2."Shkalla e katërt", paragrafi 264 dhe referencat e përmendura aty). Për më tepër, vlerësimi i drejtësisë së një procedure në tërësinë e saj, është një ndër premisat kryesore të

praktikës gjyqësore e Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës, KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).

55. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin përkatës. (Për një sqarim më të detajuar përkitazi me konceptin e “*aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*”, shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
56. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata thekson se përtej pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i vërtetimit të gabuar të fakteve dhe interpretimit të gabuar të ligjit, parashtruesi i kërkesës nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë “*qartazi i gabuar*”, duke rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës apo se si procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe të kenë qenë arbitrare. Për më tepër, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës të paraqitura përmes padisë, ankesës dhe revizionit, respektivisht dhe kanë arsyetuar të njëjtat.
57. Rrjedhimisht, pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm lidhur me vërtetimin e pronësisë në ngastrat kontestuese, kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të “*ligjshmërisë*” dhe nuk janë argumentuar në nivel të “*kushtetutshmërisë*”. Për pasojë, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
58. Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesi e kërkesës pretendon edhe (i) shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak se gjyqtari i Gjykatës Themelore, përkatësisht A.B., i cili ka marrë pjesë në nxjerrjen e Aktgjykimit [C.nr.21/10] të 19 qershorit 2013 në Gjykatën Themelore, “*ka ndikuar në vendimmarrjen e aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme*”

për shkak se parashtruesi i kërkesës “ka paraqitë padi për kompensim dëmi kundër tij”; dhe (ii) shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, duke mos i ofruar Gjykatës asnjë arsytim.

59. Gjykata konsideron se këto pretendime bien në kategorinë e pretendimeve “të pambështetura apo paarsyetuara”. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata, duke u bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafët (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, vazhdimisht ka theksuar se (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.
60. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsytim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. (Shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës KIO2/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; dhe KIO5/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31; shih gjithashtu Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 280 deri më 283).
61. Për më tepër, në kontekst të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për “anësinë” e një gjykate, e në këtë rast Gjykatës Supreme, Gjykata vë theks në faktin që e drejta në një gjykatë të paanshme është aspekt esencial i garancive procedurale të përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Ajo ka shtjelluar parimet themelore që ngërthen kjo e drejtë, në të paktën tri Aktgjykime, Aktgjykimin në rastin KIO24/17 të 24 korrikut 2019, Aktgjykimin në rastin KIO128/17 të 26 gushtit 2019 dhe Aktgjykimin në rastet KIO87/18 dhe KIO11/19 të 26 gushtit 2019. Në këto tri Aktgjykime, Gjykata ka elaboruar (i) parimet e përgjithshme të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së lidhur me kriteret për vlerësimin e paanësisë së një gjykate; (ii) konceptin e paanësisë subjektive dhe objektive të gjykatës; (iii) praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në aspekt të vlerësimit të paanshmërisë së gjykatës, përkatësisht konceptin e “*dyshimeve legjitime*” dhe faktit që të njëjtat duhet të jenë “*objektivisht të justifikueshme*” në mënyrë që të konstatohet paanësia e një gjykate. Megjithatë, përkitazi me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës, nuk ka paraqitur asnjë argument konkret bazuar në Kushtetutë, KEDNJ apo edhe praktikën e lartcekur gjyqësore. Njëjtë ka vepruar edhe përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
62. Prandaj, në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata thekson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës që ndërlidhen me “anësinë e Gjykatës” dhe të drejtës së tij në pronë, përbëjnë “pretendime të pambështetura apo të paarsyetuara”, dhe si të tilla, të njëjtat janë qartazi të

pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

63. Gjykata në këtë aspekt gjithashtu thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
64. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si pasojë e (i) mos arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe mos zbatimit të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI22/16, reflektojnë “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (ii) vërtetimit të gabuar të fakteve dhe aplikimit të gabuar të ligjit, përbëjnë pretendime të “*shkallës së katërt*”; dhe (iii) anësisë së Gjykatës Supreme për shkak të “*ndikimit të gjyqtarit të Gjykatës Themelore A.B*” dhe shkeljeve të pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës, përbëjnë pretendime të “*pambështetura apo të paarsyetuara*”. Si të tilla, të gjitha janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.
65. Përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2020, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani
Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi